



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 50, datë 20 .11. 2012

**PËR**

**“RIORGANIZIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, MIRATIMIN E RREGULLORES DHE NDRYSHIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË KLUBIT SPORTIV “TIRANA”**

Në mbështetje të nenit 2 pika 4, nenit 7 pika 2, nenit 8 pika1/I, gërma “b”, nenit 10 pika 3/II, nenit 32 gërma “ç” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); neneve 11, 113, 124 pika1, 125 dhe 126 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar); ligjit nr.9376, dt.21.04.2005, për “Sportin” (i ndryshuar); nenit 5 gërmat “a” dhe “b” të ligjit nr.10405, datë 24.03.2011 për “Kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.354, datë 29.08.1994 “Për shpërblimin e cilësisë së veprimtarive sportive për sportistët, trajnerët e gjyqtarët dhe shpërblime të tjera për veprimtaritë sportive” (i ndryshuar); pikës 17 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1619, datë 02.07.2008 për “Klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësisve të qeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 9, datë 21.03.2005 për “Miratimin e strukturës organizative dhe nivelit të pagave të Klubit Sportiv “Tirana” dhe Klubit të Futbollit “Tirana” dhe vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 7, datë 30.03.2009 për “Riorganizimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të disa ndërmarrjeje në varësi të Bashkisë së Tiranës, përfitimin e trajtimit për përgatitjen e sportistëve të nivelit të lartë, si dhe mbi përdorimin e fondit rezervë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

**V E N D O S I**

1. Të miratojë riorganizimin e strukturës organizative të Klubit Sportiv “Tirana”, sipas organigramës bashkëlidhur me një numër total punonjësish 26, si dhe nivelin e pagave të punonjësve sipas lidhjes nr.7/1 bashkëlidhur.
2. Të miratojë rregulloren e Klubit Sportiv “Tirana”.
3. Të miratojë pagesën deri në 200 (dyqind) lekë për orë mësimore për 25 trainerët joefektivë sipas kategorisë së tyre, sipas tabelës bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij vendimi.
  - a- Për trainerët të ekipeve zinxhir (të rinjtë, para të rinjtë), deri në 40 orë në muaj.
  - b- Për trainerët e zv/trainer të ekipeve të para, deri në 60 orë në muaj.

4. Të miratojë shpenzimet e udhëtimit brenda vendit, si dhe pagesat/kuotat për licensimet dhe federimet e sportistëve .
5. Pika 1 e vendimit të Këshillit Bashkiak nr.9, datë 21.03.2005 për “Miratimin e strukturës organizative dhe nivelit të pagave të Klubit Sportiv ‘Tirana’ dhe Klubit të Futbollit ‘Tirana’, si dhe pika 2 gërma “f” e vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 7, datë 30.03.2009 për “Riorganizimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të disa ndërmarrjeve të varësi të Bashkisë së Tiranës, përfitimin e trajtimit për përgatitjen e sportistëve të nivelit të lartë si dhe mbi përdorimin e fondit rezervë”, revokohen.
6. Efektet financiare të këtij vendimi për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative, do të përballohen nga buxheti i Klubit Sportiv “Tirana” për vitin 2013 dhe fillojnë më 1 janar 2013.
7. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Klubi Sportiv “Tirana”, për zbatimin e këtij Vendimi.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

**Niazi KOSOVRASTI**